



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot

Përmet më, _____. ____ 2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT PROCEDURË E HAPUR -PUNË, PROKURIM ELEKTRONIK

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rehabilitimi i rezervuarit Qilarisht

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2 - Punime ndërtimi, 45247270-3 - Punime ndërtimi për rezervuarë

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **24 805 385,84** (njëzetë e katër milion e tetëqind e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë presje tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022 dhe 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **2021, 2022 dhe 2023**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, **për vitin 2023**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së).

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM

nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/ faturë tatimore të deklaruar në organet tatimore;
- Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe Prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

NP – 1 A (Punime gërmimi në tokë)

NP – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)

NP – 6 A (Diga dhe tunele hidroteknike)

NP – 7 A (Ujësjellësa,gazsjellësa,vajsjellësa,vepra kullimi e vaditje)

NP – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Për punimet speciale të ndërtimit:

NS – 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

NS– 18 A (Punime topogjeodezike)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

Kategorite dhe nivelet e licencave te kerkuara jane bazuar ne Lidhjen 2,3 dhe 4 te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	3.106/a,3.48/b,2.47/an etj	A	0-20 milion
NP-2	Ndertime civile dhe industriale	Zeri nr 9, An , 3.246, 3.288 etj	A	0-20 milion
NP-6	Diga dhe tunele hidroteknike.	Blloku i punimeve A.2 Punime Dheu ne trup te diges	A	0-20 milion
NP-7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Punimet qe kryhen ne rezervuar (Punime te shkrkuesi katastrofik A.3)	A	0-20 milion
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor Zeri nr. 3.2, 3.3, 3.7 , 3.59/a, zerin nr 12 An etj...	A	0-20 milion
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Zeri 11 An , 3.48/b etj...	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	3.106/a, 3.48/b, 3.158/4a, 2.47/an, 3.211, 3.210+an etj...	A	0-20 milion

2.3.3 Operatori/ët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt** i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunitit).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **te përfshirë në licencën e shoqërisë**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme,

diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Inxhinier ndertimi: 1 (nje)
- Inxhinier mekanik: 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder : 1 (nje)
- Inxhinier gjeolog: 1 (nje)
- Inxhinier hidroteknik: 1 (nje)
- Inxhinier gjeoteknik: 1 (nje)
- Inxh. Mjedisi i specializuar **për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe auditimin mjedisor: 1 (nje)**

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kjo kërkesë është përcaktuar pas analizimit që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet edhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë dhe marrë në konsideratë kompleksitetin e punimeve që do të realizohen, referuar këtu projekt-preventivit të zbatimit, është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit të tij, inxhinierët e kërkuar në këtë pikë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **40 (dyzetë) punonjës** të pasqyruar në listëpagesen e muajit të fundit. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosja e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështrirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve, mbështetur në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

LLOGARITJA E NUMRIT TE PUNONJESVE

Nr	Nr.Anal	Përshkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Ore Pune	Ore Pune total	Dite Pune
A		PUNIME PER REHABILITIMIN E DIGES SE REZERVUARIT QILARISHT					
A.1		Punime skarifikimi ne trup te diges					
1	3.2	Prerje bime te vogla ø-10cm	m ²	11,600	0.08	928	116.00
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm	cope	670	0.4	268	33.50

3	3.7	Shkulje e rrenjeve te bimeve te vogla	cope	540	0.2	108	13.50
A.2		Punime Dheu ne trup te diges				0	0.00
4	3.106/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne mjet (bjefi i siperm pjesa e kalldremi)	m ³	1,604	0.071	114	14.24
5	3.48/b	Rafshim skarpate me krahe ne germim toke e zakonshme(bjefi i siperm)	m ²	1,540	0.45	693	86.63
6	3.48/b	Rafshim skarpate me krahe ne germim toke e zakonshme(bjefi i poshtem)	m ²	9,900	0.45	4,455	556.88
7	3.59/a	Pastrim rezervuari heqje aluvionesh nga(bjefi i siperm , shkarkuesi katastrofik) me ekskavator me krahe te gjate ne prezence uji dhe shkarkim ne mjet	m ³	108	3.7	400	49.95
8	3.210+an	Shtrese çakelli kave t=15cm, perhapur e ngjeshur e ngeshur me tokmak (bjefi I siperm kalldremi)	m ²	1,540	0.21	323	40.43
9	An	Shtresë kalldrëmi 20-25 cm mbi shtresën e çakellit	m ²	1,540	0.6	924	115.50
10	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri (kurora e diges)	m ²	660	0.28	185	23.10
11	an	Shblokimi I kanalit fundor te diges nga aluvionet (nga vepra e hyrjes bjefi i siperm ne dalje, bjefi i poshtem) me makineri sonde me reze lazer.	ml	97	2.5	243	30.31
12	an	Rehabilitim i sipefaqes mjedisore te demtuara dhe kthimi ne gjendjen e meparshme ,	m ²	5,520	0.1	552	69.00
13	3.158/4a	Transport dheu me auto deri 4.0 km	m ³	1,769,27	0.8	1,415	176.93
A.3		Punime te shkarkuesi katastrofik				0	0.00
14	2.47/an	Germim shkambi mesatar me cekic me ekskavator me zinxhire	m ³	402.00	0.4	161	20.10
15	3.182/b	Shtrese zhavor lumi t=15cm	m ²	324.00	0.1	32	4.05
16	3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25	m ³	168.00	12.9	2,167	270.90
17	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	kg	8.80	42.0	370	46.20
18	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri (rruga per te shkarkuesi fundor)	m ²	472.00	0.28	132	16.52
Dite pune total							1683.7
Afati i realizimit 3 muaj (66 dit pune)							66
Numri i punonjesve							25.5
Stafi teknik (dr teknik + staf mbeshtetes + drejtues mjetesh)							14
Numri total i punonjesve							40

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë (Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

- 1 (një) punonjës *Ekspert Zjarrfikës* në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikës te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, kontrata e vlefshme e punës si edhe Licence per shërbime ekspertize ne kete fushe, leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit. (Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për mbarëvajtjen, ndërhyrjen, parandalimin dhe evitimin e situatave apo problematikave lidhur me rreziqet, sigurinë dhe shëndetin në punë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet edhe në dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, VKM nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në dispozitat e akteve të sipërcituara, ndër të tjera parashikohet se: punëdhënësi merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm; organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimin e punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre; punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës; çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Pra, në dispozitat e akteve të mësipërme, përcaktohen kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik, emergjencë apo të papritura në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës, i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës, duke patur në fokus primar jetën dhe shëndetin e punonjësve të angazhuar me zbatimin e punimeve.

Argumentimi: Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), i ndryshuar, citohet: “Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta”

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyruës, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në ndërtime të reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel të trajnuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar muajin e fundit dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjesit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

- Teknik Ndertimi – 1 punonjes
- Hidraulik – 1 punonjes
- Betonues – 5 punonjes
- Mekanik – 1 punonjes
- Saldator – 1 punonjes
- Hekurkthyes – 2 Punonjes
- Karpentier – 5 punonjes

Për punonjësit me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikimit, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkohet diplomes/certifikates së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzes/regjstrit dhe data e leshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/dëshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.”
**(Per teknikat e mesem duhet të paraqitet diploma ose deftesa e perfundimit të shkolles se mesme profesionale).*
- Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të punës, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

-1 (një) Teknik Ndertimi,

Eshtë kërkuar për ndjekjen e punimeve të ndryshme në kantier, me organizimet e punimeve orientimin e proceseve të punimeve të ndryshme sipas grafikut të punimeve.

-1 (një) hidraulike

Per punimet e ndryshme sipas preventivit zerat me nr 11.an,12.an etj

- 5 (pese) betonues
- 2 (dy) hekurkthyes
- 1 (nje) saldator

Per punimet e ndryshme sipas preventivit zeri nr.9 an , zeri nr.15 an 3.182/b, zeri 16 an 3.246, zeri 18 an 3.211 etj

- 5 (pese) karpentier

Per punimet e ndryshme ne objekt, ndjekjen e te gjitha proceseve te punes ne kantier dhe orientimin e proceseve te ndryshme etj...

- 1 (nje) mekanik

Per punimet ne zërat nr.11 an dhe 3.288

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se ka të punësuar muajin e fundit dhe figuron në listëpagesat e subjektit, punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Shofer – 2 punonjes
- Eskavatorist/Manovrator – 2 punonjes

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Keta profesione jane te domosdoshem pasi sipas pikes 2.3.9 per te gjitha mjetet motorrike do te behet perdorimi i tyre nga keta specialist (ku theksohet qe nje drejtues mjete mund te drejtoj disa mjete ne kanter).

- ❖ Eskavatorist/Manovrator do te drejtojne keto mjete: Eskavator me zinxhir , Minieskavator, Eskavator me krah mbi 18 m, Fadroma me goma, Rrule gome hekur
- ❖ Shofer do te drejtojne keto mjete: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12-20 ton, Kamioncine me kapaciteti 1 -1.5 ton, Kamioncine vetëshkarkuese 2 – 5 ton, Auto Betoniere, Autopompe Betoni, Autovinc, Autobot uji me sprucator etj...

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për

stafin mbështetës të kërkuar në objekt, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Nëpërmjet këtij stafi, synohet realizimi i objektit të kontratës brenda afatit, normave dhe me cilësi sipas standardeve në fuqi. Stafin mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.9 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nr	Lloji i Makinerive	Njesia	Sasia	Statusi
1	Eskavator me zinxhir	Copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Minieskavator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me krah mbi 18 m	Copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Fadrome me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Kamioncine me kapacitet 1 - 1.5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Kamionçine vetëshkarkuese 2 – 5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Cekic per Eskavator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator ngjeshes	Copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Rrule gome hekur	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12	AutoBetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Autopompe Betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Autovinc	Copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Kompresor	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Autobot uji me sprucator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Matrapik	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Depozita uji 5000 l	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Pompe uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Sistem makinerie e drejtuar me lazer per realizim mikrotyneli me Ø (250-1000) mm	Copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Betoniere/motobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Paisje per hekurthyes (tranxhe/elektrobango)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Kokore	Copë	20	Në pronësi ose me qera
26	Jelek	Copë	20	Në pronësi ose me qera
27	Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Komplet i ndihmës së shpejtë	Copë	2	Në pronësi ose me qera
29	Tabela paralajmeruese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Karroca dore	Copë	3	Në pronësi ose me qera

- a) Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (Çertifikatë Pronësie e mjetit nëse nuk është pajisur me lejen e re të qarkullimit), leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit Teknik (te vlefshme), siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (Çertifikatë Pronësie e mjetit nëse nuk është pajisur me lejen e re të qarkullimit), leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit Teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë (e vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.
- e) Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjate vleresimit të ofertave ashtu edhe gjate zbatimit të kontratës.
- f) Makinerite e mesiperme nuk duhet të jene të angazhuara në kontrata të tjera, (Deklarate nga Administratori i Shoqerise Ofertuese).

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.9 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i mjeteve, makinerive e pajisjeve të cilat duhet të disponohen nga OE në njërin prej formave të kërkuara, janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket disponimit të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, e për këtë qëllim janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave të përcaktuara. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve dhe

mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në manualin e çmimeve në fuqi, si dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 20 ton	1	në pronësi ose me qira
---	---	------------------------

Kamioni është i domosdoshëm për të gjitha shtresat e zhavorit të lumit, stabilizantit, rres bituminozë etj pasi do bëhet transporti i tyre për në objekt.

Kamioncine me kapacitet 1 - 1.5 ton	1	në pronësi ose me qira
Kamioncine vetëshkarkuese 2 – 5 ton	1	në pronësi ose me qira

Keto mjete do të nevojiten për të sjell në kantier materialet e lehta dhe vegla pune nga me të ndryshme, po ashtu do të bëjnë të mundur dhe transportimin e stafit së bashku me puntoret çdo ditë nga kantieri.

Eskavator me zinxhir	1	në pronësi ose me qira
Ekskavator me krahë mbi 18 m	1	në pronësi ose me qira
Minieskavator	1	në pronësi ose me qira
Cekic për Eskavator	1	në pronësi ose me qira
Fadroma me goma	1	në pronësi ose me qira

Keto mjete do të shërbejnë për kryerjen e germimeve të ndryshme sipas projektit. Po ashtu me keto mjete do të bëhet hapja dhe sistemimi i çakullit dhe shtreave përkatëse sipas projektit, kryhet levizja e materialeve brenda kantierit, krijimi i argjinaturave etj...

Auto Betoniere	1	në pronësi ose me qira
Rrul gome hekur	1	në pronësi ose me qira
Vibrator betoni	2	në pronësi ose me qira
Vibrator ngjeshes	1	në pronësi ose me qira
Betoniere/motobetoniere	1	në pronësi ose me qira
Autopompë betoni	1	në pronësi ose me qira

Keto mjete do të shërbejnë për sjelljen e betonit për shtresat e ndryshme të planifikuara në projekt, për dërgimin e betonit në zona të ndryshme dhe në lartësi të ndryshme nëpërmjet autopompës së betonit dhe Vibratori i betonit do të kryej procesin e vibrimit dhe bëjnë sa më kompakt sipas kushteve teknike betonin e kërkuar në kantier. Ndërsa ruli do të shërbejë për ngjeshje të shtresave të ndryshme sipas analizave teknike përkatëse.

Pajisje për largim të ujërave nëntokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point)	1	në pronësi ose me qira
--	---	------------------------

Sistem makinerie e drejtuar me lazer per realizim mikrotyneli me Ø (250-1000) mm	1	në pronësi ose me qira
--	---	------------------------

Kjo paisje jane te domosdoshme per punimet ne dige per largimin e ujrave te rezervuarit, pastrimin e vepres se marrjes se ujit dhe shkarkuesit fundor te rezervuarit.

Autovinc	1	në pronësi ose me qira
----------	---	------------------------

Ky kamion sherben per transportin dhe ngritjen e materialet te cilat e kane te nevojshme shkarkimin me vinc si cemento hekur etj ...

Kompresor	1	Në pronësi ose me qera
Saldatrice	1	Në pronësi ose me qera
Matrapik	1	Në pronësi ose me qera

Keto paisje jane per prishjen me cekic te formacioneve te forta shkembore qe mund te dalin sipas projektit dhe saldimin e hekurave sipas nevojës ne kantier.

Autobot uji me sprucator	1	Në pronësi ose me qera
--------------------------	---	------------------------

Ky mjet nevojitet per furnizimin me uje ne kantier.

Depozita uji 5000 l	1	Në pronësi ose me qera
Pompe uji	1	Në pronësi ose me qera

Keto paisje nevojiten per mbajtjen e ujit ne kantier dhe pompa per dergimin e tij ne mjet apo vendodhje te ndryshme brenda kantierit.

Paisje per hekurkthyes (tranxhe/elektrobango)	1	Në pronësi ose me qera
---	---	------------------------

Kjo paisje nevojitet per kthimin e hekurit dhe prerjen e tij.

Kokore	20	Në pronësi ose me qera
Jelek	20	Në pronësi ose me qera
Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili	1	Në pronësi ose me qera
Komplet i ndihmës së shpejtë	2	Në pronësi ose me qera

Keto paisje jane te domosdoshme ne kantier per sigurine e punonjesve te ndryshem , per dallimin e tyre dhe ne raste emergjente fiksja e zjarrit se bashku me kutine e ndihmes se shpejte.

Tabela paralajmeruese	1	Në pronësi ose me qera
-----------------------	---	------------------------

Keto nevojiten per orientimin dhe palajmerimin ne kantier per punimet qe po kryejne

Karroca dore	3	Në pronësi ose me qera
--------------	---	------------------------

Keto Pajisje i nevojiten punetorve te thjeshte per te bere te mundur levizjen e materialeve te vogla brenda kantierit dhe pastrimet e siperfaqeve te ndryshme, depozitimin e tyre prane nje vendodhje te percaktuar.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- **Certifikatën për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë

Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

- Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2023 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta. **ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga njësia e prokurimit.

- U diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe u bë miratimi i dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 15.01.2025, ora 11⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al** .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

**MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Alma HOXHA**